

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Riparim I pikes panoramike te qytetit”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45453000-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

1 618 250 (nje milion e gjashtëqind e tetembwdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) leke pa tvsh lekë pa Tvsh

Bazuar në nenin 76 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” e ndryshuar, në zbatim të urdhërit të titullarit, për ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës për procedurën e prokurimit, komisoni pasi u njoh me objektin e prokurimit, bazuar në VKM 285 datë 19.05.2021 neni 76, ka bere llogaritjen sipas mesatares së 3 ofertave nga testimi te tregut.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoritet kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimi/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk duhet të jete me e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë e arrijnë vlerën në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, 55 per procedurën e hapur e thjeshtuar të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Kërkesa për paraqitjen e xhiros vetëm për dy vite është hartuar në raport me objektin e prokurimit duke marrë në konsideratë përcaktimin e kriterëve të thjeshtuara të pranimi me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël e të mesëm.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuar të bilancit të vitit 2024 nga autoritetet përkatëse tatimore.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024

Përcaktimi i vitit të kërkuar për paraqitjen e bilancit 2024 është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore".

Kërkesa është hartuar në raport me objektin e prokurimit duke marrë në konsideratë përcaktimin e kriterëve të thjeshtuara të pranimit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2025, nga organet e qeverisjes vendore për pikat ku ushtrohet aktiviteti sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontratë të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga shpallja e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës.

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit.

Përvoja e mëparshme është një element i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë përvojën e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik, për të vërtetuar se mallrat objekt prokurimi plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë si më poshtë:

- Certificate e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet,

proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave si çertifikata ISO e cila është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar suksesin e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamionvinç	copë	1	Në pronësi ose me qera

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); c) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. nenin 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se: *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit“.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit.

Mjeti tip kamionvinc do te sherbeje per montimin e xhamave.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë 5 punetore për të cilët duhet të dorëzojë:

- Kontrate individuale të punës.
- Listëpagesat për muajin aktual.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore për të zbatuar kontratën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë në përmbushjen e objektit të kontratës vlerësohet me përvojën e duhur dhe personelin e nevojshëm, siç kërkohej nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se „5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit“.

Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, pasi për realizimin e objektit të kontratës sipas zërave të preventivit nevojiten punetoret e sipërpërmendur.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikime teknike:

Parapeti xhami nr1. - Ballore:

Modeli i parapetit: Parapeti xhami me baze alumini U të vazhduar

Finitura e aluminit: Anodizim 12 micron (ngjyrë e zeze)

Lidhja e aluminit: EN-AW 6063

Konfigurimi xhami: 12 mm UltraClear Temperuar + 1,52 mm PVB/EVA + 12 mm UltraClear Temperuar

Aksesorë: Pllaka sthreguese dhe me opsion regjistrimi të përhershëm të xhamit (jo kunjë pa vida)

Prixhonjere: M12 x 150 mm

Lartesia e perfunduar: 128 cm

Certifikata e rezistences: 3,0 kN/m te aplikuar ne krye te xhamit, per lartesine e caktuar me siper.

Parapet xhami nr1. - Ballore:

Modeli i parapetit: Parapet xhami me baze alumini U te vazhduar

Finitura e aluminit: Anodizim 12 micron (ngjyre e zeze)

Lidhja e aluminit: EN-AW 6063

Konfigurim xhami: 10 mm UltraClear Temperuar + 1,52 mm PVB/EVA + 10 mm UltraClear Temperuar

Aksesore: Pllaka sthreguese dhe me option regjistrimi te perhershëm te xhamit (jo kunjja pa vida)

Prixhonjere: M12 x 120 mm

Lartesia e perfunduar: 115 cm

Certifikata e rezistences: 3,0 kN/m te aplikuar ne krye te xhamit, per lartesine e caktuar me siper.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistët e fushës, pjesë e DST.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e mallit dhe lidhen ngushtë me natyrën e kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo specifikim dhe standard të kërkuar.**

NJESIA E PROKURIMIT